1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

|   |       |
|---|-------|
| Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....   | ..... |
| Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve .....  | ..... |
| Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....  | ..... |
| Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial .....   | ..... |
| Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....  | ..... |
| Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit .....  | ..... |
| Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....  | ..... |
| Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit .....   | ..... |
| Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....  | ..... |
| <a href="#">Shtojca 10.</a> Formulari i Njoftimit të Fituesit.....  | ..... |
| <a href="#">Shtojca 11.</a> Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)   |       |
| <a href="#">Shtojca 12.</a> Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër                           |       |
| <a href="#">Shtojca 13.</a> Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit) |       |

---

**Shtojca1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>   | <i>3</i>     | <i>4</i>               | <i>6</i>                                 |              |
|---|--|--------------|------------------------|--|--------------|
| <b>Artikulli</b>                          | <b>Përshkrimi i mallit</b>                         | <b>Sasia</b> | <b>çmimi per njësi</b> | <b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b> | <b>Afati</b> |
| 1.  | Automjet, furgon frigoriferik 10-13 m <sup>3</sup> | 1            |                        |  | 31.12.2024   |
| <b>Çmimi total (Mallrat)</b>              |  |              |                        |  | _____        |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |  |              |                        |  |              |
| <b>TVSH (%)</b>                           |  |              |                        |  |              |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |  |              |                        |  |              |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |              |                        |  |              |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |              |                        |  |              |
| <b>Vula</b>                               |  |              |                        |  |              |
| <b>Datë</b> _____                         |  |              |                        |  |              |

**Shtojca 3.***[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik ]*



---

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] sikundër për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 4.**

---

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

---

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### Specifikimet teknike

#### Automjeti: Automjet, furgon frigoriferik 10-13 m<sup>3</sup>

|               |                         |
|---------------|-------------------------|
| Lloji:        | furgon frigoriferik atv |
| Aksi i pasëm: | goma teke               |
| Kambio:       | manuale/automatike      |

#### Të dhënat e ngarkesës:

|                                   |           |
|-----------------------------------|-----------|
| Masa maksimale e autorizuar (kg): | 3000-3500 |
| Masa bruto e ngarkesës (kg)       | 1100-1600 |

#### Të dhëna tmotorrike:

|                          |                |
|--------------------------|----------------|
| Vëllimi e motorrit (cc): | 1900-2300      |
| Fuqia motorrike (kw):    | 75-110         |
| Lloji i karburantit:     | diesel (naftë) |
| Numri i pistonave:       | 4              |

#### Përmasat e jashmte:

|  |           |
|--|-----------|
| Gjatësia e përgjithshme (mm):              | 5300-6000 |
| Gjerësia e përgjithshme (pa pasqyra) (mm): | 2000-2100 |
| Lartësia totale (nga toka) (mm):           | 2200-2800 |
| Lagësia e akseve (mm):                     | 3400-4000 |

---

Përmasat e brendshme të ngarkesës (pa termoizolim):

Gjatësia e hapësirës së ngarkesës (mm): 3000-3600

Gjerësia e hapësirës së ngarkesës (mm): 1700-2000

Lartësia e hapësirës së ngarkesës (mm): 1600-2200

Vëllimi i ngarkesës (m<sup>3</sup>) 10-13

Dera e pasme: derë me dy kanate me hapje me mentesha.

Dera anësore: derë anësore me shinë me rrëshqitje, me gjerësi 1200-1300 mm (euro palet).

Sistemi frigoriferik:

Furgoni të jetë frigoriferik.

Faqet e brendshme të veshur me materialin standard frigorifer për ruajtjen e temperaturës.

Frigoriferi duhet të jetë ftohës me temperaturë minimale 0 °C

Pulti i komandimit të frigoriferit duhet të jetë në kabinën e shoferit.

Pulti duhet të jetë i pajisur me komandat standard të komandimit: ndezje, fikje, rregullim temperature, dhe ekran për treguesit e temperaturës.

Termoizolimi duhet të jetë antibakterial dhe i realizuar me material të çertifikuar nga EU.

Aparati ftohës duhet të jetë prodhim për EU, i çertifikuar.

Të dhëna të tjera:

Viti i prodhimit: furgoni duhet të jetë prodhim i vitit 2024

Kilometra të kryera: automjeti duhet të jetë me 0 km

Ngjyra e automjetit: e bardhë

Sistemi i frenimit abs.

Sistem drejtimi elektro-hidraulik.

Timoni në krahun e majtë.

Ajër i kondicionuar.

Kompjuter bordi

Kabina e shoferit: numri i vendeve 3 (tre)

Radio, usb ose cd player.

Gomat: të katër gomat duhet të jenë të reja, prodhim i vitit 2024

Automjeti duhet të jetë i pajisur edhe me gomë rezervë, dhe aksesoret për ndërrimin e gomës.

Çelësa: 2 (dy) kopje.

**Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike.**

*Për hartimin e specifikimeve teknike të automjetit frigoriferik, komisioni i është referuar specifikave respektive në raport me natyrën e aktivitetit që furgonat kryejnë kapacitetin e mallrave që ata duhet të transportojnë, plotësimin e standardeve higjienosanitare për transportin e produkteve ushqimore si dhe destinacionet respektive që automjeti parashikohet të përshkrojë, në varësi të specifikave të rrugës që ai përshkrojë për të transportuar produktet pranë secilit prej çerdheve apo kopshteve.*

---

*Për përcaktimin e parametrave për automjetin e kërkuar, komisioni i është referuar informacioneve që gjenden lehtësisht në internet mbi parametrat dhe kapacitetet e mundshme të mjeteve të markave të ndryshme.*

*Parametrat e përcaktuara për automjetin e transportit me kapacitet 10-13 m<sup>3</sup>, janë vendosur duke patur parasysh se ky automjet do të jetë në shërbim të AK në destinacione të përcaktuara për shpërndarje produktesh ushqimore në sasi të madhe për të përballuar furnizimin për rreth 15-20 kopshte dhe çerdhe.*

*Duke qenë se institucioni ynë disponon aktualisht automjete frigoriferikë ATV të markave të ndryshme, Komisioni iu është referuar specifikave dhe parametrave të tyre, duke përcaktuar segmente parametrash dhe përmasash gjithëpërfshirëse, duke përcaktuar parametra maksimale dhe minimale të cilat plotësojnë kërkesat e institucionit në raport me aktivitetin funksional që ky automjet do të kryejë.*

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

**Llojet dhe sasia e mallit që do të lëvrohet është si më poshtë:**

| Nr | EMERTIMI   | Njesia | Sasia | Afati i lëvrimit                            |
|----|--|--------|-------|---|
| 1  | Automjet, furgon frigoriferik 10-13 m <sup>3</sup> | copë   | 1     | Brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës |

#### **Afatet e lëvrimit:**

- Lëvrimi i mallit nga shitësi në DPÇK do të kryhet jo më vonë se 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast brenda datës 31.12.2024.
- Automjeti do të lëvrohet pranë DPÇK në adresën: “Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë”.
- Ditën e lëvrimit të mallit pranë DPÇK, OE kontraktor duhet të paraqesë **Çertifikatën e Konformitetit të automjetit**, të lëshuar nga prodhuesi.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



---

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. OE duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

---

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB:

**Kategoria:** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”.

**Nënkategoria:** “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”.

**Kodi:** VII.3.B.2

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jetë pajisur me Çertifikaten ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme, e leshuar nga nje organ i akredituar.

2.3.4 OE duhet të paraqesë Garanci të Automjetit jo më pak se 100.000 km ose 2 vite përdorim nga momenti i levrimit (cila prej tyre do arrihet e para). OE duhet të deklaroje kushtet teknike te garancise dhe sherbimet e perfshira brënda periudhes se garancise.

2.3.5 OE duhet të garantoje servis te specializuar per riparimin e automjetit. Për këtë OE duhet të paraqesë një vetdeklarim ku të deklaroje se disponon në pronësi ose në përdorim servis, për gjithë periudhën e garancisë së automjetit, i cili disponon liçencë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB, si më poshtë:

**Kategoria:** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”.

**Nënkategoria:** “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**Kodi:** VII.3.B.1

Operatori ekonomik i **klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentat provuese për vetdeklarimin e sipërpërmendur (dokumentat e pronësisë/kontratës së përdorimit, si dhe licencën përkatëse të servisit).

2.3.6 OE duhet te paraqese **Çertifikat e Konformitetit të ngjashme** me mallin qe shitet.

2.3.7 OE konkurues duhet të paraqesë katalogun e automjetit, ose pjesë të shkëputura nga katalogu, ku të tregohet tipi i automjetit dhe parametrat e kërkuar të tij në specifikimet teknike.

**Për sistemin frigoriferik të automjetit, OE duhet të paraqesë:**

2.3.8 OE duhet te paraqesë **Çertifikatë të Konformitetit të ngjashme** për sistemin frigoriferik.

- 
- 2.3.9 OE konkurues duhet të paraqesë informacion të plotë mbi të dhënat teknike të sistemit frigoriferik (pasaportë teknike dhe/ose pjesë të katalogut ku përcaktohen parametrat teknikë, dhe /ose çdo dokument tjetër që jep informacion të plotë për parametrat teknikë).
- 2.3.10 OE duhet të paraqesë Garanci për Sistemin frigoriferik, jo më pak se 2 vite përdorim nga momenti levrimit. Gjithashtu OE duhet të deklarojë kushtet teknike të garancisë dhe shërbimet e përfshira për gjatë gjithë periudhës së saj.
- 2.3.11 OE duhet të paraqesë një vetdeklarim ku të garantojë servis të specializuar për riparimin e sistemit frigoriferik, si dhe të deklarojë servisin ku do të kryhen shërbimet e sistemit frigoriferik, përgjatë gjithë periudhës së garancisë.  
Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentat provuese për vetdeklarimin e sipërpërmendur (dokumentat e pronësisë ose kontratë bashkëpunimi, licencën përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër që vërteton se servisi është i specializuar për kryerjen e shërbimeve të sistemit frigoriferik).

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njëzuar me origjinalin.**

**Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licencuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njëzuar kopja me origjinalin nga Noteri.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentim për hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:**

*Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Komisioni ka patur në vëmendje sigurimin e cilësisë dhe garancisë për automjetin e kërkuar. Duke iu referuar rëndësisë dhe natyrës specifike dhe të veçantë që ai do të kryej gjatë aktivitetit të përditshëm për transportimin e produkteve ushqimore në çerdhet dhe kopshtet e Bashkisë së Tiranës.*

- *Kërkesa që OE duhet të jetë i pajisur me Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, Nënkatëoria: “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura”, Kodi: VII.3.B.2, është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të*

---

*Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Udhezimit nr. 1545, dt. 29.03.2016, “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe /ose rimorkiove të reja ose të përdorura, te autorizuar nga prodhuesi”.*

- *Kërkesa që Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, konsiston në kërkesën që OE konkures duhet të sigurojë mbi cilësinë e automjetit të ofruara.*
- *Kërkesa që OE duhet të paraqesë Garanci të Automjetit jo më pak se 100.000 km ose 2 vite përdorim nga moment i levrimit (cila do arrihet e para) dhe se OE duhet të deklarojë kushtet teknike të garancisë dhe shërbimet e përfshira brenda periudhës së garancisë është hartuar me qëllim që AK të sigurohet që mjeti nuk do të pësojë defekte në një periudhë të afërt dhe OE të ketë përgjegjësi për mjetin gjatë kësaj periudhe. Në rast se kjo do të ndodhë, duhet të jenë të përcaktuara saktësisht kushtet dhe zërat përkatës mbi të cilat është e vlefshme garancia.*
- *Referuar kësaj kërkesë është vendosur edhe kërkesa që OE duhet të garantojë servis të specializuar për riparimin e automjetit si dhe të deklarojë servis ku do të kryhen shërbimet. Për servis duhet të paraqesë: Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”. Nënkatëgoria: “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Kodi: VII.3.B.1. Nëpërmjet kësaj kërkesë AK do të sigurohet që shërbimet e përfshira në garancinë e deklaruar nga OE do të kryhen në një operator të specializuar për këtë aktivitet.*
- *Për të garantuar që automjeti është prodhuar konform standardeve të kërkuara, kërkohet që OE duhet të paraqesë Certifikatën e Konformitetit të prodhuesit për automjetin e ofruar. Për arsye se Certifikata e Konformitetit nga prodhuesi për automjetin hartohet pasi automjeti të jetë prodhuar, është kërkuar që OE konkures duhet që të paraqesë një Certifikatë Konformiteti të ngjashme (të një automjeti tjetër, që ai aktualisht e disponon), në mënyrë që AK të sigurohet që OE konkures zbaton procedurat standarde për tregëtimin e automjetit të reja. Certifikata e konformitetit për automjetin e ofruar do të paraqitet nga OE kontraktor sëbashku me automjetin në momentin e levrimit.*
- *Kriteri që OE konkures duhet të paraqesë katalogun e automjetit, ose pjesë të shkëputura nga katalogu është vendosur që AK të vlerësojë që automjeti i ofruar plotëson parametrat e kërkuara në specifikimet teknike.*

*Në lidhje me sistemin frigoriferik:*

- *Sikurse edhe në kërkesat për automjetin, për të garantuar që sistemi frigoriferik i automjetit është prodhuar konform standardeve të kërkuara, OE për sistemin frigoriferik duhet të paraqesë Certifikatën e Konformitetit të prodhuesit.*
- *Kriteri që OE konkures duhet të paraqesë informacion të plotë mbi të dhënat teknike të sistemit frigoriferik, është vendosur që OE të tregojë dhe të garrtojë që sistemi frigoriferik plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.*
- *Kriteri që OE duhet të paraqesë Garanci për Sistemin frigoriferik, jo më pak se 2 vite përdorim nga moment i levrimit është vendosur për arsyen se OE duhet të garantojë funksionimin pa problem të sistemit frigoriferik të automjetit të lëvruar, për një periudhë kohe prej 2 vitesh si dhe duhet të deklarojë kushtet teknike të garancisë dhe shërbimet e përfshira brenda periudhës së garancisë.*
- *Për plotësimin e këtij kriteri, OE duhet të garantojë servis të specializuar për riparimin e sistemit frigoriferik si dhe të deklarojë servis ku do të kryhen shërbimet, me qëllim që AK të*

---

*sigurohet që OE i disponon të gjitha kapacitetet për riparimin dhe kryerjen e shërbimeve të sistemit frigoriferik.*

**Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:**

*Fondi limit është përcaktuar referuar:*

- *Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për "Blerje automjeti, furgon frigoriferik" për çerdhet dhe kopshtet e Bashkisë Tiranë për Vitin 2024.*
- *Proçes – Verbalit të Testimit të Tregut.*
- *Fondit të miratuar nga Bashkia Tiranë.*

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| Identifikimi   | Përgjigjja   |
|--|--------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----        |
| Numri NIPT/et:   | -----        |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | -----        |
| Përfaqësuesi (emri):   | -----        |
| Telefoni:  | -----        |
| E-mail:  | -----<br>--- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

|   |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul> |
|---|

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT –i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|---|
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

| Emri (at) e subjekteve | NIPT-i | Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik | Specifiko konkretisht kapacitetin/et |
|------------------------|--------|--|--------------------------------------|
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |
|                        |        |  |                                      |

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

| Deklarata  |
|--|
| <p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>                                |
| <p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p> |

---

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë (**Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID**) :

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*



Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Përqëllim të kësajdeklarate dhe ofertësëparaqitur, unëkuptojqëfjala “konkurrentë” nënkuptonçdo operator tjetëreekonomik, të ndryshëmngaOfertuesi, të paraqiturose jo sibashkimoperatorëshekonomik, që:
  - a) paraqesinnjëofertënëpërgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të FtesëspërOfertë, të bërëngaAutoritetiKontraktor;
  - b) ështënjëofertuesimundshëm, icilibazuarnëkualifikimin, aftësitëosepërvojat e tij, mundet të dorëzojnëofertënëpërgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të FtesëspërOfertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Nëveçanti, pa kufizuarparagrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendurmëlart, nuk ka pasurkonsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjëkonkurrentnëlidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorëtoseformulat e përdorurapërlllogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendiminpër të paraqitur apo jo njëofertë; ose,
- d) paraqitjen e njëoferteqë nuk i plotësonspecifikimet e kërkesës përofertë.

8. Përveçkësaj, nuk ka pasurkonsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjëkonkurrentnëlidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokuriminnëfjalë, përveç se kurjanëdeklaruar sipasparagrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janëbërë të njohura dhe as nuk do t'ubëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, nëçdomënyrëqoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligjosenëse deklarohet në mënyrëspecifike sipasparagrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

| Deklarata  |
|--|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br><br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.  |
